

## **AKT THEMELIMI**

Sot ne dt. 12.06.2023 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

**ALEXANDRA-DANA SPINEANU**, e datelindjes 03.06.1983, e lindur ne BUCUREST dhe banuese ne Korfuz,Greqi, me adrese Asirmatos,Potamu,Korfuz,Greqi, madhore me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes me Nr.063210964, leshuar nga Bucuresti me date 28/12/2022,

**PETROS PAPIKINOS**, i datelindjes 03.03.1976, i lindur ne Korfuz, Greqi dhe banues ne Korfuz,Greqi, me adrese Asirmatos,Potamu,Korfuz,Greqi,madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.AO 758089,

te cilet me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin "**AMT TRAVEL & TOURS**" shpk.

### KREU I

#### Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti

##### Neni 1

##### Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**AMT TRAVEL & TOURS**" shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjisllacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

##### Neni 2

##### Forma Juridike

Shoqeria "**AMT TRAVEL & TOURS**" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**AMT TRAVEL & TOURS**" shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket themelues që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

##### Neni 3

##### Selia

#### **Shoqeria e ka seline ne adresen:**

**Lagjia nr.2, Rruga Onhezmi, Godina nr.8/183+1-162, kati 13, Apartamenti nr.5, Sarande.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakeve themelues.

#### Neni 4

### **Objekti i veprimtarise**

- **Shërbime turistike, operator turistik, agjensi turistike, agjensi udhëtimesh turistike,**
- **prerje biletash për udhëtarët për transportet detare dhe tokësore,**
  - **transport udhëtarësh me mjete tokësore,**
  - **lundrime ditore,**
  - **dhënie me qira e automjeteve,**
  - **akomodim,**
  - **shoqërim i turistëve me mjete tokësore,**
  - **dhe çdo shërbim tjetër në fushën e turizmit.**

#### Neni 5

### **Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB).

#### KREU II

### **KAPITALI**

#### Neni 6

### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë.

Kapitali i shoqërisë është 100,000 leke i përbërë nga 2 kuota dhe zotërohet nga ortakët e shoqërisë si më poshtë :

- Ortaku Themelues: **ALEXANDRA-DANA SPINEANU**, zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 75,000 Leke, e cila përfaqëson 75 % të kapitalit të shoqërisë,
- Ortaku Themelues: **PETROS PAPIKINOS**, zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 25,000 Leke, e cila përfaqëson 25 % të kapitalit të shoqërisë,

Vlera totale e Kapitalit të Regjistruar **100,000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit të Paguar **100,000 Leke**, do të paguhet në avance nga ortakët.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundërt të tregtueshme deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë;

#### Neni 7

### **Transferimi i kapitalit**

Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm.



Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

## KREU II ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

### Neni 8 Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakut të vetëm themelues është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut të vetëm është organi vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e Ortakut të vetëm brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

### Neni 9 Administrimi

**ALEXANDRA-DANA SPINEANU**, e datelindjes 03.06.1983, e lindur në BUCUREST dhe banuese në Korfuz, Greqi, me adresë Asirmatos, Potamu, Korfuz, Greqi, madhore me zotësi juridike dhe për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes me Nr.063210964, leshuar nga Bucuresti me datë 28/12/2022,

Emerimi i administratorit është me një afat pesë vjeçar me të drejtë riemerimi, i cili ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e themelimit të shoqërisë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese së ortakut të vetëm të shoqërisë.

### Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese së ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohe të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në



emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene a.Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

b.Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c.Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italiane dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqërise tregtare "**AMT TRAVEL & TOURS**" shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

**ORTAKËT SHOQËRISE**

**ALEXANDRA-DANA SPINEANU**



**PETROS PAPIKINOS**

